SHTOJCA 2

Struktura e Dokumentit së Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor, 2025-2027

BASHKIA FIER

PROJEKT DOKUMENTI

PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM
2025 - 2027

Faza II

Gusht 2024

PËRMBAJTJA

LOGO..... ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

1. HYRJE.....**5**

1.1 ROLI DHE QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM, SI NJË INSTRUMENT EFEKTIV PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR 5
1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË.....7

2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË (1-2 FAQE).....**10**

2.1 SITUATA E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE.....10
2.2 ÇËSHTJE KRYESORE PËR PROJEKTET DHE POLITIKAT E BASHKISË / KËSHILLIT TË QARKUT 14

3. ORIENTIMI AFATGJATË I BASHKISË / KËSHILLIT TË QARKUT (1-2 FAQE) ..... ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

3.1 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT AFATGJATË.....**ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.**
3.2 SFIDAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT / PARAQITJA E PROJEKTEVE KRYESORE – ARSYET DHE PËRFITUESIT.....**ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.**

4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË/QARKUT [EMRI] 2025-2027 .....**17**

4.1 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË BASHKISË FIER NË VITET 2025-2027.....18
4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Fier për vitet 2025-2027 .....*18*
2.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Fier për periudhën 2025-2027 .....*37*
4.2 INVESTIMET PUBLIKE NË NIVEL VENDOR.....55

5. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE **56**

5.1.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit.....*57*
5.1.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit *60*
5.1.3 Projektet e Investimeve të Programit.....*65*
5.1.4 Informacione Bazë mbi Programin.....*65*

6. BUXHETI VJETOR..... ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

6.1. DOKUMENTACIONI BAZË .....**ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.**
6.2. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES .....**ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.**

Lista e Tabelave

Tabela 1. Informacion Bazë mbi Bashkinë Fier *17*
Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit *18*
Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike......*37*
Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programit dhe kategorive ekonomike.....*49*
Tabela 5. Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Funksional (Niveli I, II, III i COFOG) *53*
Tabela 5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike.....*56*
Tabela 6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit *57*
Tabela 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit.....*60*
Tabela 8. Projektet e Investimeve të Programit.....*65*
Tabela 9. Informacione bazë mbi Programit.....*65*

Lista e Shkurtimeve

PBA – Programi Buxhetor Afatmesëm
NJVV – Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
EMP – Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS – Grupi për Menaxhimin Strategjik
MF – Ministria e Financave
FPT – Instrumenti i Planifikimit Financiar
INSTAT – Instituti i Statistikave
PBB – Produkti i Brendshëm Bruto
SMBV – Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor

1. HYRJE

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjeçare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve .

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar

kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësive vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësia vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës* së *Programit*, synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e perfomancës të lidhura me ato në terma SMART[1]. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë[2] (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën tre-vjecare[3], sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet e NJVQV-së duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektivave të Programeve të saj.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja, specifikon

[1] **S**pecifike, **M**atshme, **A**rritshme, **R**ëndësishme, **T**erma **K**ohore.

[2] 'Afatgjatë' I referohet një kohe të specifikuar nga Drejtuesi i Programit, që shkon përtej periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

[3] Për tu specifikuar për secilin vit të periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zemrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së . Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësia vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart[4] i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MF-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

[4] Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për "Proçedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar.

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2025-2027 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavaneve të përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV) dhe Manualin e Përdorimit të tij.

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MF, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandiime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Me marrjen e Udhezimit plotesues te Ministrise se Financave nr.89 date 05.07.2024 "Per pergatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2025-2027",dhe miratimit te tavaneve perfundimtare te shpenzimeve te buxhetit afatmesem 2025-2027 nga Keshilli i NJQV-se, Kryetari i njesise se veteqeverisjes vendore ka nxjerre urdherin nr.358 me numer 8286 prot., date 09.08.2024 "Per pergatitjen e Programit Buxhetor Aftmesem 2025-2027 dhe Buxhetit te vitit 2025,Faza II", drejtuar EMP (Ekipeve te Menaxhimit te Programeve) dhe Njesive Shpenzuese te Bashkise Fier.
Duke qene se tavanet perfundimtare jane te njejta me tavanet pergatitore te miratuara ne Fazen e Pare te pergatitjes se PBA-se 2025-2027, dhe shpenzimet nuk kane pesuar ndryshime ,pra nuk kemi produktet shtese te prodhuara apo projektet e investimeve shtese.

Gjate kesaj faze Ekipet e Menaxhimit te Programeve buxhetore EMP-te kane bere rishikimin e DPP dhe PSHP brenda tavanit te Fazes se dyte. Ne keto ndryshime jane marre per baze mendimet **e dhena nga Ministria e Financave gjate fazes se pare, protokolluar me shkrese prane Bashkise Fier me nr. 7319 prot., date 09.07.2024 , dhe jane planifikuar shpenzime per fondin rezerve me kod programi 04910 dhe shpenzime per fondin e kontigjences me kod programi 04940 .**

"Fondi Rezerve" eshte fondi ,qe krijohet per te financuar shpenzime jo te perhershme dhe te paparashikuara,ne fazen e pergatitjes se buxhetit.

"Fondi i Kontigjences" eshte fondi i pashperndare,qe krijohet per te mbuluar risqet e mundshme,per te ardhuart dhe shpenzimet,gjate zbatimit te buxhetit.

Pasi eshte bere miratimi i te gjitha formateve te PBA-se ne Fazen e dyte, Dokumenti i PBA-se se Fazes se dyte (Dokumenti i Rishikuar i PBA-se) eshte aprovuar nga Koordinatori i GMS dhe i eshte paraqitur GMS-se per miratimin perfundimtar,procesverbal nr. date 30.08.2024.

Duke qene se ne kete faze nuk kemi ndryshime ne tavanet perfundimtare dhe ne shpenzime per produkte dhe projekte investime,projekt dokumenti i progrramit afatmesem 2025-2027 ,i rishikuar,nuk jane kryer seanca degjimore me komunitetin dhe grupet e interesit.

Projekt dokumenti i finalizuar eshte publikuar ne faqen e Bashkise Fier.

Pasi Keshilli te miratoj dokumentin e PBA-se te Fazes se dyte (Dokumenti i Rishikuar i PBA-se) ,njesia e veteqeverisjes vendore dergon ne Ministrine e Financave dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesem te rishikuar, te miratuar nga keshilli i njesise, se bashku me nje informacion mbi rekomandimet e dhena nga Ministria e Financave gjate fazes se pare.

Faza 3 e procesit të PBA-së dhe Buxhetit Vjetor përshkon periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor kur NJVQV-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin e MF). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJ

2. Vështrim i Përgjithshëm i Bashkisë

2.1 Situata e Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore

Bashkia Fier shtrihet ne pjesen perendimore te Shqiperise, ne jug te fiushes s eMyzeqese dhe laget nga deti Ardiatik ne perimetrin e saj perendimor, ne nje gjatesi perej 32 km, Pozita gjeografike e Fierit eshte mjaft e favorshme per shkak se ne territorin e saj kalojne dy nga korridoret me te rendesishme rrugore te vendit: Korridori i III dhe korridori i IV.

Me nje siperfaqe prej 66150 ha Bashkia Fier ka ne perberje te saj 10 Njesi Administrative, respektivisht Fier, Cakran, Dermenas, Frakull, Levan, libofshe, Mbrostar, Portez, Qender, Topoje.

Bashkia e Fierit karakterizohet nga një terren fushor me lartësi mesatare prej 20 metrash mbi nivelin e detit dhe kufizohet me bashkitë: Divjakë, Lushnje, Roskovec, Patos, Mallakastër, Selenicë dhe Vlorë.

Figura 1. Ndarja administrative e Bashkisë Fier



Bashkia e Fierit gëzon një pozicion strategjik në territorin shqiptar i mundësuar nga disa avantazhe ndërsektoriale. Ajo kufizohet nga dy lumenj kryesorë, Semani në veri dhe Vjosa në jug, të cilët kanë sipërfaqe të mbrojtura natyrore pranë grykëderdhjeve të tyre; zotëronParkun Arkeologjik Kombëtar të Apolonisë; trashëgon zona industriale dhe naftëmbajtëse si

dhe gëzon pozicion strategjik avantazhues për sa i përket gazifikimit të mundshëm, mevënien në zbatim të Gazsjellësit TAP që kalon brenda territorit të saj.

Reforma Administrative-Territoriale e ndërmarrë në vitin 2014 ndikoi në Bashkinë e Fierit duke i ndryshuar shtrirjen dhe kufijtë territorialë, duke i shtuar në përbërje të saj edhe njësi të reja administrative. Para ndarjes territoriale Bashkia e Fierit, e cila kishte në përbërje të saj vetëm qytetin e Fierit dhe 17 lagjet e tij, kishte një sipërfaqe prej 800 ha[2] dhe një popullsi prej 82,262 banorë. Pas reformës, Bashkia e re e Fierit ka një sipërfaqe prej 620 km2 si dhe një popullsi prej 122,475 banorësh [3] . Bazuar në Ligjin Nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo – territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë",Fieri mbetet qendra e Qarkut të Fierit, ndërsa qarku vetë ka në përbërje të tij bashkitë e reja tëMallakastrës, Patosit, Fierit, Lushnjes, Roskovecit dhe Divjakës.

- **Monumentet dhe zonat e mbrojtura natyrore**

Zonat e mbrojtura, edhe pse disa prej tyre gjenden në kufi me Bashkinë e Fierit dhe nuk administrohen nga kjo bashki, kanë një zonë buferike prej 50m nga kufiri që kushtëzon zhvillimin.

- Monumentet natyrore (Zonë e Mbrojtur, kategoria III) janë:
-
- Dunat e Semanit;
- Pishat e zeza në bregdetin e Poros;
- Kurora e lumit të vjetër të Semanit (Libofshë Adriatik);
- Rrapet e rrugës Fier-Vlorë dhe rrapi i pazarit të Cakranit (Çaireve).

Dunat e Semanit ndodhen në bregdet, në veriperëndim të fshatit Povelçë. Ato përfaqësojnë grupe dunash të krijuara nga veprimtaria akumuluese e erës në rërën e plazheve. Ato janë rreth 1km të gjata, 15m të gjera dhe 6m të larta. Veçori e tyre është vendosja në një brez gati linear me drejtim veri-jug. Aty pranë ndodhet edhe Plazhi i Semanit që është një prejplazheve më piktoreske në Shqipëri. Ai është rreth 3.5km i gjatë dhe rreth 2km i gjerë. Dy prej veçorive unike të këtij plazhi janë rëra e imët dhe pyjet e bukura me pisha. Deti është i cekët dhe shumë i përshtatshëm për pushime familjare e me fëmijë. Dunat kanë vlera shkencore (biologjike), ekologjike, kulturore dhe turistike.

Kurora e lumit të vjetër Seman e ka marrë emrin prej formës që ka. Kjo kurorë ndodhet në rrjedhjen e poshtme të Lumit Seman, pranë fshatit Adriatik, në afërsi të Libofshës, rreth 10m mbi nivelin e detit. Ajo përbën një shtrat të dikurshëm të lumit Seman, të braktisur prej tij, si pasojë e karakterit tepër endacak në këtë sektor të rrjedhjes së tij. Ajo ka një pyll me sipërfaqe 44ha. Pylli i Kurorës është një muze i gjallë, me drurë karakteristikë e biodiversitet të lartë. Bimët barishtore të tipit të limaneve, që ngjiten në plepat e lartë, bashkëshoqërimi dhe dendësia e shumë llojeve bimore, dihatjet e faunës së egër e sidomos bretkosave dhegjinkallave, të japin ndjesinë e një "xhungle" të vogël mesdhetare.

- **Zona të mbrojtura**

Laguna e Karavastasë gjendet në kufirin verior në Divjakë. Kjo lagunë është shpallur parkkombëtar (Kategoria II).

Sistemi ligatinor i Nartës dhe Vjosës në pjesën jugore është shpallur peizazh i mbrojtur(Kategoria V).
Pylli i Levanit (199 ha) si dhe pylli i Pishë-Poros (1575 ha) janë shpallur rezervate natyrore të manaxhuar/park natyror (Zonë e mbrojtur, kategoria III e IV).

- **Monumentet e kulturës dhe zonat arkeologjike**

Bashkia Fier është në një kryqëzim sa antik dhe modern rrugësh. Dikur në territorin e saj shtrihej një nga kolonitë më të hershme të bregdetit Adriatik, e njohur si Apollonia e Ilirisë, ndërsa sot është parku arkeologjik më i madh i ultësirës perëndimore shqiptare e një prej më të vizituarve.

Apollonia është një park arkeologjik me potencial të lartë zhvillimi në funksion të vizitave turistike dhe të edukimit por prej vitesh, mungesa e një plani menaxhimi e ka penalizuar parkun me zhvillime projektesh që jo përherë kanë qenë në unison me njëri-tjetrin apo jo pak herë edhe me mbivendosje me njëri-tjetrin.

Aktualisht parku arkeologjik ka një gjendje të mirë të ruajtjes e konservimit por njëkohësisht nevoja emergjente të ndërhyrjeve specifike e kyçe restauruese në monumentet brenda tij të të gjitha periudhave. Projektet restauruese me financim të Bashkbimit Europian janë pjesë thelbësore e ndryshimit pozitiv por ende nuk ka një qartësi të linjave rrugore të cilat do të lidhin by-passin e Fierit me Apolloninë, dhe sa ky aks do të lehtësojë aksesin e vizitorëve poredhe të banorëve vendas.

Nga Apollonia fillonte në antikitet një degë e rëndësishme e Via Egnatia-s e natyrshëm qyteti është destinacion i vizitorëve të shumtë, të cilët mbërrijnë jo vetëm me automjete por edheme mjete të tipit biçikletë, dhe ku nuk mungon hapësira për itinerare të cilat mund ti drejtojnëvizitorët drejt detit Adriatik, sikurse edhe itinerare mes fshatrave të cilat ndodhen në lindje të Apollonisë në drejtim të qytetit të Fierit.

Bashkia Fier, ka potencialin gjithashtu edhe të prezencës së manastirit të Shën Kozmait në Kolkondas, një monument që është natyrshëm pjesë e itinerareve të kishave bizantine të ultësirës perëdimore sepse bart historinë e Shën Kozmait dhe frymën e pelegrinazhit historik. Kombinimi i resurseve të pasura kulturore me përmirësimin e infrastrukturës rrugore por edhe asaj turistike sjell pashmangshmërisht zhvillimin të qëndrueshëm ekonomik lokal e rritje të interesimit të banorëve për vlerat që i rrethojnë.

Për monumentet e kulturës përcaktohet një zonë mbrojtëse përreth, në përputhje me vlerat e tyre arkitektonike dhe me përshtatshmërinë e tyre urbanistiko-estetike. Përmasat e kësaj zone, ku ndalohet çdo ndërhyrje me karakter ndërtimor, janë përcaktuar nga organi që e ka shpallur monumentin, sipas studimit të bërë nga Instituti i Monumenteve te Kulturës.

Monumentet kulturore janë:

- Kisha e Shën Kollit, Vanaj
- Kisha e Shën Gjergjit, Libofshë
- Kisha e Shën Kozmait, Kolkondas
- Kisha e Shën Premtes, Hoxharë
- Vila Romake, Plyk
- Manastiri i Shën Mërisë, Pojan
- Qyteti antik Apolonia, Pojan
- Tempulli antik, Shtyllas

Zonat kryesore me vlerë historike janë:

- Apolonia
- Manastiri i Shën Mërisë
- Manastiri i Ardenicës (nuk është në bashkinë e sotme, por është në afërsi)

Parku i Apollonisë është arkivuar në shqyrtim për t'u konsideruar pasuri botërore nga UNESCO-ja nga Ministria e Mjedisit.[21] Parku i Apolonisë është një zonë prej 81 ha, kufiri itë cilës u caktua si një zonë arkeologjike e mbrojtur, e përbërë nga një zonë me intensitet të lartë arkeologjik (A) dhe (B) një zonë për zhvillimin e hapësirës së mbrojtur. Krahas Parkut Arkeologjik të Apolonisë, në Bashkinë e Fierit ndodhen dhe 17 monumente kulture të kategorisë së parë.

Kisha e Shën Mërisë ndodhet mbi fshatin Pojan, në manastirin i Shën Mërisë së Apolonisë. Kjo kishë është një nga monumentet më të rëndesishme arkitektonike të kultit mesjetar në Shqipëri. Për arsye të mungesës së mbishkrimit themelor që dëshmon datën e saktë të ndërtimit, studiuesit janë përpjekur të nxjerrin konkluzione në mënyrë të tërthortë, duke u detyruar të mbeshteten në piktura, mbishkrime dhe stile arkitektonike, që ruan në vetvete ky manastir. Kompleksi i Manastirit të Marisë Hyjlindëse përbehet, nga kisha e Shën Mërisë, paraklisi i Shën Mitrit dhe skevofilakioni (vendi i enëve të kultit), të cilët i janë ngjitur kishës në anën veriore. Tre studiues të këtij manastiri si Aleksudhi, Leon Hezej dhe Dome mendojnë se, kisha e Shën Mërisë duhet të jetë ndërtuar mbi themelet e faltores (tempullit) së Apolonit.[22]

Qyteti antik i Apolonisë mendohet të jetë themeluar rreth vitit 600 para Krishtit. Fiset ilire që gjendeshin në afërsi të Apolonisë ishin Bylinët, Desaretët dhe Taulantët. Apolonia njihej sinjë port lumor dhe të ardhurat më të mëdha i kishte nga marrëdhëniet tregtare. Një tërmet i fuqishëm që zhvendosi rrjedhjen e lumit Vjosa dhe shtoi distancën e Apolonisë me detin Adriatik, u bë shkak që të fillonte rënia. Shkaqet ekonomike së bashku më forcimin e vendbanimeve të tjera antike bëri që Apolonia të humbiste vlerën e saj. Gjatë periudhave të mëvonshme ajo nuk u shtrytëzua më si vendbanim, por shpesh gurët u mbartën nga Apolonia për të ndërtuar vepra të tjera më në fushë. Apolonia njihej edhe si pika e nisjes së pjesës jugore të rrugës Egnantia, që lidhte Perandorinë Romake me trevat më në thellësi të Ballkanit[23].

Kolona e Shtyllasit përbëhet nga gurë gëlqerorë të punuar. Ajo përbëhet nga 7 blloqe guri në formë trung koni. Shtylla është e vendosur mbi një kodër rreth 50 m mbi nivelin e detit nga ku dallohet shumë qartë tempulli i Pojanit dhe kisha e Shën Premtes në Hoxharë. Zona ku ndodhet shtylla është një pllajë e vogël me një sipërfaqe 5700 m² dhe mendohet që këtu afër të ketë patur ndërtime të tjera[24].

Figura 11. Monumentet dhe zonat të mbrojtur



Bashkia Fier fokusin e saj e ka tek permiresimi i jetes se qytetareve duke ngritur tregje rajonale, pika te grumbullimit dhe industrializimit per prodhimet bujqesore.

Rikonstruksionin e godinave shkollore deri ne 100% te tyre, ndertimin e shkollave te reja, rikonstruksion e rrugeve jo vetem ne qytet por edhe ne te gjitha Njesite Administrative, ndricimi deri ne shtepine me te larget nga qendra por sidomos krijimin e lehtesirave ne jeten e perditshme te gytetareve te saj.

2.2 Çështje Kryesore për Projektet dhe Politikat e Bashkisë Fier

Pozicionimi strategjik dhe pikat e forta në territor

Fieri shtrihet në pjesën perëndimore të Shqipërisë, në jug të Fushës së Myzeqesë dhe ndodhet 18 km larg bregut të Detit Adriatik. Bashkia e Fierit shtrihet në një pozitë gjeografike dhe strategjike të favorshme duke parë që në këtë bashki kalojnë dy nga korridoret më të rëndësishme të vendit të cilët janë Korridori VIII dhe Korridori i Kaltër (Autostrada Adriatiko-Joniane). Autostrada, e cila do të lidhë Lushnjën me Fierin dhe Vlorën, do të jetë një arterie e fuqishme transporti nga dhe në drejtim të Fierit. Ajo do të kalojë në një distancë afërsisht 2 km nga qendra e Fierit 27. Qendra e qytetit ka dy lidhje kryesore, një pjesën veriore me rrugën e Celigradit dhe një tjetër në pjesën perëndimore me rrugën e Semanit. Një tjetër linjë e rëndësishme komunikacioni është infrastruktura hekurudhore ku në Bashkinë e Fierit kalojnë linjat Tiranë - Vlorë dhe Tiranë - Ballsh.

Bashkia e Fierit gëzon një pozicion strategjik në territorin shqiptar i mundësuar nga disa avantazhe ndërsektoriale. Ajo përbën 5.7%28 të tokës bujqësore; kufizohet nga dy lumenj kryesor, Semani në veri dhe Vjosa në jug, të cilët kanë sipërfaqe të mbrojtura natyrore pranë grykëderdhjeve të tyre; zotëron Parkun Arkeologjik Kombëtar të Apolonisë; trashëgon zona industriale dhe naftëmbajtëse si dhe gëzon pozicion strategjik avantazhues për sa i përket gazifikimit të mundshëm, me vënien në zbatim të Gazsjellësit TAP që kalon brenda territorit të saj.

Reforma Administrativo - Territoriale e ndërmarrë në vitin 2014 ndikoi në Bashkinë e Fierit duke i ndryshuar shtrirjen dhe kufijtë territorialë, duke i shtuar në përbërje të saj edhe njësi të reja administrative. Para ndarjes territoriale Bashkia e Fierit, e cila kishte në përbërje të saj vetëm qytetin e Fierit dhe 17 lagjet e tij, kishte një sipërfaqe prej 800 ha dhe një popullsi prej 82,262 banorësh (Plani i Përgjithshëm Rregullues i qytetit të Fierit, 2006). Pas reformës, Bashkia e re e Fierit ka një sipërfaqe prej 620 km229 si dhe një popullsi prej 122,475 banorësh30. Ajo përbëhet nga 10 njësi administrative të cilat janë: Fier, Mbrostar, Topojë, Dërmenas, Levan, Frakull, Cakran, Libofshë, Portëz dhe Qendër. Bazuar po në Ligjin Nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo – territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Fieri mbetet qendra e Qarkut të Fierit, ndërsa qarku vetë ka në përbërje të tij bashkitë e reja të Mallakastrës, Patosit, Fierit, Lushnjes, Roskovecit dhe Divjakës.

Pikat e forta në territor:

Ky seksion trajton elementet që kanë vlerë të spikatur territoriale, apo historike, duke gjeneruar kështu formë apo aktivitete rreth vetes. Këta elementë janë baza e zhvillimit të mëtejshëm të vendbanimeve. Ato mund të shfaqen në forma apo situata që favorizojnë, por edhe kundërshtojnë/pengojnë zhvillimin, duke realizuar kështu ndikimin e tyre në territor. Shtrirja e tyre fizike dhe ndikimi i tyre në territor mund të jetë pikësor/qendror, por edhe sipërfaqësor, në formën e fashave të ndikimit. Elementët e tillë mund të jenë natyrorë, por edhe artificialisht të krijuar nga njeriu.

Në territorin e bashkisë Fier, elementet e forta natyrore janë të shumtë dhe lidhen me gjendjen topografike dhe pasuritë e shumta ujore. Ndër to mund të përmendim:

- Dunat e Semanit, të cilat gjenden në pjesën perëndimore të territorit të Bashkisë dhe janë pjesë e zonës bregdetare të Adriatikut. Ato përbëjnë një potencial të rëndësishëm natyror për zhvillimin e turzimit dhe mbrojtjen e plazhit në këtë zonë;

- Pishat e zeza në bregdetin e Poros janë masivi i drurëve të cilët përbëjnë atë quhet Pylli i Pishë-Poros dhe përbën një element të rëndësishëm natyror i cili kufizon shtrijen e ndërtimeve në këtë zonë por edhe orienton për zhvillim e turizmit bregdetar. Ndikimi i këtij elementi është sipërfaqësor dhe ndikon në mënyrë të përgjithshme të gjithë territorin e bashkisë;

- Kurora e lumit të vjetër të Semanit (Libofshë Adriatik) është një element natyror i fortë i pajisur me drurë të lartë pranë fshatit Adriatik dhe pranë Lumit të Semanit. Kjo shihet si një pikë qendrore natyrore në mes të fushave bujqësore;

- Rrapet e rrugës Fier-Vlorë dhe rrapi i pazarit të Cakranit (Çaireve) janë elementë natyrorë të cilët përbëjnë potencial për krijimin e hapësirave publike pranë tyre si dhe orjentojnë krijimin e qendrave të vendbanimeve. Këto hapësira mund të kthehen në pika kyçe të itenerareve natyrore të cilat do të propozohen në territoret e bashkisë Fier;

- Parku i Levanit është një element kyç natyror i bashkisë Fier i cili ka një potencial të jashtëzakonshëm peisazhistik. Ai shërben si element qëndror për gjithë territorin e Bashkisë pasi ndodhet shumë pranë rrugëve kryesore ekzistuese dhe pranë vendbanimeve kryesore.

Elementët artificialë janë po aq të rëndësishëm në mënyrën e ndikimit në territor ashtu si elementët natyrorë. Ato janë krijuar nga veprimtaria njerëzore dhe mbartin edhe pjesën e identitetit kulturor dhe historik të zonës. Këto elemente janë të rëndësishme për potencialin që ato mbartin për sa i përket zhvillimit social–ekonomik të bashkisë Fier. Ndër to përmendim:

- **Elementet e forta artificiale**

Në territorin e Bashkisë Fier shtrihen një numër i madh objektesh të shpallura monumente, si: Kisha e Shën Kollit, Vanaj, Kisha e Shën Gjergjit, Libofshë, Kisha e Shën Kozmait, Kisha e Shën Premtes, Hoxharë, Vila Romake, Plyk - Manastiri i Shën Mërisë, Pojan - Qyteti antik Apolonia, Pojan - Tempulli antik, Shtyllas. Këto kisha janë elemente kryesorë territorialë për shkak të impaktit që kanë në zhvillimin territorial, ekonomik dhe social të territorit ku shtrihen. Këto objekte kulturore përbëjnë një potencial të madh historik, kulturor për zonën. Ato priren të orientojnë zhvillimin e territorit ku pranë të cilave mund të përcaktohen qendrat urbane, qendrat e vendbanimeve, hapësirat publike, atraksionet turistike si pjesë e programeve turistike etj.

- **Zona industriale**

Uzina e Plehrave Azotike është një element i rëndësishëm territorial artificial i cili lidhet ngushtësisht me identitetin e qytetit të Fierit. Impakti më i madh është ai në aspektin mjedisor si dhe në aspektin social – ekonomik. Zona industriale e Azotikut zë një hapësirë të konsiderueshme, rreth 50 Ha, dhe për momentin shërben si vend-depozitim i mbetjeve të asbestit, pa funksione të tjera mbështetëse të veprimtarisë industriale. Rijetëzimi i këtij brownfield-i dhe rehabilitimi tërësor i tij është një ndër prioritetet që merr parasysh ky document në zhvillimet strategjike të ardhshme.

Zona Naftënxjerrëse e Mbrostarit është nje element tjetër formë-gjenrues, i cili përbën dhe potencial edhe kufizim për territorin e Bashkisë Fier. Ajo e kufizon territorin në aspektin e përdorimit bujqësor e implikimeve mjedisore, orienton zhvillimin e vendbanimeve dhe bujqësisë në zona të tjera dhe kthehet në qendër të zhvillimit të industrisë.

- **Institucione Shëndetësore**

Spitali Rajonal i Fierit ka një impakt të gjërë në jetën e komunitetit në bashkinë e Fierit si një element i fortë fizik i cili ndikon në plotësimin e shërbimeve publike bazë. Përveç tij, spitali i ri rajonal i Fierit, i cili pritet të ndërtohet në Pyllin e Levanit, do ketë mbulim për gjithë Rajonin e Shqipërisë së Jugut, duke përbërë një ndër investimet më të mëdha të karakterit social në bashki.

- **TAP**

Projekti për Gazsjellësin Trans-Adriatik kalon nëpër Bashkinë Fier në zonën veriore të saj, në njësitë administrative Topojë, Libofshë, Qendër dhe Mbrostar. Ky projekt është miratuar dhe kushtëzon të gjitha autoritet planifikuese që ta marrin në konsideratë planin sektorial në hartimin e instrumenteve të planifikimit. Projekti i TAP dhe gjurma e tij (përfshirë këtu edhe fashën e linjës prej 500 m, e cila është shpallur Zonë e Rëndësisë Kombëtare) ka një ndikim në territorin fizik të bashkisë, pasi në zonën ku kalon gjurma e gazsjellësit do të ketë kushtëzime përsa i përket zhvillimit të territorit. Fasha do të shërbejë si zonë buferike dhe nuk do të lejohen ndërtimet në tre brezat e parë të saj (8, 20 dhe 100 metra në secilën anë).

4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË FIER

Ky seksion i kushtohet alokimit të burimeve për shpenzime publike të Bashkisë Fier gjatë periudhës 2025-2027, si dhe projekteve kryesore të investimeve publike, nëse janë planifikuar të tillë. Nënseksioni i parë, prezanton të ardhurat e parashikuara për periudhën 2025-2027, me një shpjegim për secilin grup të të ardhurave së bashku me supozimet kryesore të bëra gjatë parashikimit. Nënseksioni i dytë, paraqet një përmbledhje të planeve të shpenzimeve të Bashkisë për vitet 2025-2027. Ky nënseksion prezanton informacionin mbi shpenzimet totale sipas kategorive ekonomike, programit dhe funksioneve qeverisëse. Në vijim paraqiten projektet kryesore të investimeve publike të planifikuara nga Bashkia.

Tabela 1 paraqet të dhëna bazë mbi bashkinë që përshkruajnë demografinë, sipërfaqen, komunitetin dhe bazën e biznesit, kapacitetin menaxhues, etj.

Tabela 1. Informacion Bazë mbi Bashkinë Fier

		Të Përgjithshme	2020	2021	2022	2023	2024
1	Numri i Njësive Administrative	13.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2	Numri i Fshatrave	85.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
3	Sipërfaqja e NJVQV (km2)	619.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
3.1	Qyteti	78.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
3.2	Njësitë Administrative	541.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
4	Sipërfaqja e NJVQV (km2)	541.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
4.1	Zonë Urbane	307.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
4.2	Tokë Bujqësore	193.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
4.3	Kullota	13.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
4.4	Pyje	28.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
5	Popullsia e NJVQV	0.00	206,681.00	207,108.00	207,333.00	208,604.00	209,232.00
5.1	Qyteti	0.00	94,138.00	94,729.00	94,990.00	95,839.00	96,286.00
5.2	Njësitë Administrative	0.00	112,543.00	112,379.00	112,343.00	112,765.00	112,946.00
6	Mosha Mesatare e Popullsisë	0.00	39.00	40.00	41.00	41.00	41.00
7	Numri i Lindjeve	0.00	1,141.00	1,620.00	1,106.00	1,081.00	1,053.00
8	Numri i Vdekjeve	0.00	1,360.00	1,571.00	1,107.00	1,032.00	1,027.00
9	Numri i Bizneseve Aktive	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
10	Numri i Familjeve	0.00	63,901.00	63,891.00	67,542.00	67,542.00	66,438.00
10.1	Qyteti	0.00	32,224.00	32,224.00	32,631.00	32,631.00	33,608.00
10.2	Njësitë Administrative	0.00	31,677.00	31,667.00	34,911.00	34,911.00	32,830.00
11	Numri i Punonjësve të NJVQV me Kohë të Plotë	0.00	1,390.00	1,390.00	10,390.00	1,531.00	1,548.00

		TëPërgjithshme	2020	2021	2022	2023	2024
11.1	Administrata e NJVQV	0.00	415.00	415.00	415.00	384.00	349.00
11.2	Njësitë Shpenzuese	0.00	975.00	975.00	9,975.00	1,147.00	1,199.00
12	**Numri i Punonjësve të NJVQV me Kohë të Pjesëshme**	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	30.00
12.1	Administrata e NJVQV	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
12.2	Njësitë Shpenzuese	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	30.00
13	**Numri i Programeve Buxhetore**	0.00	13.00	13.00	14.00	14.00	14.00

4.1 Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të Bashkisë Fier në vitet 2025-2027

4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Fier për vitet 2025-2027

Ky nënseksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme.

Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit

	Burimet Buxhetore	2022 Fakti	2023 Fakti	2024 Plani Fillestar	2024 Plani i Rishikuar	2025 Plani	2026 Plani	2027 Plani
1	**TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA**	567,797	641,939	744,657	744,657	742,478	744,138	744,138
1.1	**TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME**	236,901	267,800	234,115	234,115	236,038	236,038	236,038
1.1.1	Taksa mbi Ndërtesën	135,848	158,016	123,181	123,181	123,181	123,181	123,181
1.1.2	Taksa mbi tokën bujqësore	76,766	87,539	88,426	88,426	88,426	88,426	88,426
1.1.3	Taksa mbi truallin	14,333	11,714	6,431	6,431	6,431	6,431	6,431
1.1.4	Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme	9,954	10,531	16,077	16,077	18,000	18,000	18,000
1.2	**TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA**	58,343	23,455	71,000	71,000	71,000	71,000	71,000
1.2.1	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	58,343	23,455	71,000	71,000	71,000	71,000	71,000
1.3	**TAKSA TË TJERA VENDORE**	2,874	3,472	4,528	4,528	4,528	4,528	4,528
1.3.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	0	0	0	0	0	0	0
1.3.2	Taksa vendore në shërbimin hotelier	35	0	1,608	1,608	1,608	1,608	1,608
1.3.3	Taksa e tabelës	2,839	3,472	2,920	2,920	2,920	2,920	2,920
1.3.4	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testamen...	0	0	0	0	0	0	0
1.3.5	Taksa e përkohëshme	0	0	0	0	0	0	0
1.4	**TARIFA VENDORE**	247,571	322,065	400,916	400,916	396,814	398,474	398,474
1.4.1	Tarifa e menaxhimit të mbetjeve	150,415	223,713	304,650	304,650	304,650	306,650	306,650
1.4.2	Tarifa për zënien e hapësirës publike	0	0	0	0	0	0	0
1.4.3	Tarifa për ndriçimin publik	349	164	0	0	0	0	0
1.4.4	Tarifa për gjelbërimin	38,650	25,149	5,676	5,676	1,574	1,660	1,660
1.4.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	0	0	0	0	0	0	0

	Burimet Buxhetore	2022 Fakti	2023 Fakti	2024 PlaniFillestar	2024 Plani i Rishikuar	2025 Plani	2026 Plani	2027 Plani
1.4.6	Tarifa të institucioneve të arsimit	18,797	24,639	33,216	33,216	33,216	33,216	33,216
1.4.7	Tarifa të institucioneve të kulturës dhe sportit	0	0	0	0	0	0	0
1.4.8	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	0	0	0	0	0	0	0
1.4.9	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	0	0	0	0	0	0	0
1.4.10	Tarifa e përkohëshme	0	0	0	0	0	0	0
1.4.11	Tarifa e parkimit	10,282	16,790	16,357	16,357	16,357	16,357	16,357
1.4.12	Tarifa të tjera	29,078	31,610	41,017	41,017	41,017	40,591	40,591
1.5	**TË ARDHURA NGA ASETET DHE AKTIVITETI EKONOMIK**	15,833	18,560	17,473	17,473	17,473	17,473	17,473
1.5.1	Të ardhura nga ndërmarrjet publike	0	0	0	0	0	0	0
1.5.2	Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë	15,833	16,670	17,473	17,473	17,473	17,473	17,473
1.5.3	Të ardhura nga partneriteti publik privat	0	0	0	0	0	0	0
1.5.4	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	0	0	0	0	0	0	0
1.5.5	Shitja e aseteve financiare	0	0	0	0	0	0	0
1.5.6	Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	0	0	0	0	0	0	0
1.5.7	Të tjera	0	1,890	0	0	0	0	0
1.6	**TË TJERA ADMINISTRATIVE**	6,275	6,587	16,625	16,625	16,625	16,625	16,625
1.6.1	Kamatëvonesat	0	0	0	0	0	0	0
1.6.2	Gjoba, sekuestrime dhe zhvdëmtime	6,275	6,587	16,625	16,625	16,625	16,625	16,625
1.6.3	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
2	**TRANSFERTA NGA BUXHETI QËNDRON**	1,085,759	1,191,071	1,506,493	1,506,493	1,601,153	1,659,947	1,724,486
2.1	**TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME**	567,008	619,095	837,900	837,900	886,970	941,236	999,377
2.1.1	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	567,008	619,095	837,900	837,900	886,970	941,236	999,377
2.2	**TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE**	354,390	393,062	504,786	504,786	546,374	550,902	555,476
2.2.1	Konviktet e arsimit parauniversitar	0	0	22,809	22,809	22,809	23,037	23,267
2.2.2	Arsimi parashkollor - Për Personelin Arsimor	0	0	196,399	196,399	196,399	198,363	200,347
2.2.3	Arsimi parashkollor - Për stafin mbështetës	0	0	50,848	50,848	50,848	51,357	51,870
2.2.4	Arsimi parauniversitar	0	0	13,439	13,439	13,439	13,574	13,709
2.2.5	Mbrojtja nga zjarri	0	0	39,455	39,455	39,455	39,849	40,248
2.2.6	Mbrojtja sociale	0	0	27,589	27,589	27,589	27,865	28,143
2.2.7	Administrimi i pyjeve	0	0	4,810	4,810	4,810	4,858	4,906
2.2.8	Rrugët	0	0	10,542	10,542	10,542	10,648	10,754
2.2.9	Ujitja dhe Kullimi	0	0	66,917	66,917	66,917	67,586	68,262
2.2.10	Klubet shumësportëshe "Partizani" dhe "Studenti"	0	0	0	0	0	0	0
2.2.11	Menaxhimi i mbetjeve urbane	0	0	20,000	20,000	20,000	20,200	20,402
2.2.12	Rritja e nivelit të pagave	0	0	51,976	51,976	93,565	93,565	93,565
2.2.13	Të tjera	354,390	393,062	0	0	0	0	0
2.3	**TRANSFERTA TË KUSHTËZUARA**	0	0	0	0	0	0	0
2.3.1	Për funksione të deleguara	0	0	0	0	0	0	0
2.3.2	Për projekte të veçanta	0	0	0	0	0	0	0
2.4	**TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA**	164,361	178,914	163,807	163,807	167,809	167,809	169,633

	Burimet Buxhetore	2022 Fakti	2023 Fakti	2024 PlaniFillestar	2024 Plani i Rishikuar	2025 Plani	2026 Plani	2027 Plani
2.4.1	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	81,091	84,657	78,244	78,244	82,040	82,040	82,040
2.4.2	Renta minerare	27,911	23,214	26,795	26,795	27,000	27,000	27,000
2.4.3	Tatimi mbi të ardhurat personale	39,656	50,844	38,038	38,038	38,038	38,038	39,862
2.4.4	Të tjera	15,703	20,199	20,730	20,730	20,731	20,731	20,731
2.5	**TRANSFERTË SPECIFIKE**	0	0	0	0	0	0	0
2.5.1	Transfertë specifike	0	0	0	0	0	0	0
3	**GRANTE DHE TRANSFERTA TË TJERA**	0	0	0	0	0	0	0
3.1	**TRANSFERTA NGA I NJËJTI NIVEL QEVERISJE**	0	0	0	0	0	0	0
3.1.1	Transferta nga i njëjti nivel qeverisje	0	0	0	0	0	0	0
3.2	**GRANTE TË TJERA TË BRENDSHME**	0	0	0	0	0	0	0
3.2.1	Grante të Tjera të Brendshme	0	0	0	0	0	0	0
3.3	**GRANTE TË HUAJA**	0	0	0	0	0	0	0
3.3.1	Grante të huaja	0	0	0	0	0	0	0
4	**HUAMARRJA**	0	0	0	0	0	0	0
4.1	Huamarrja afatshkurtër	0	0	0	0	0	0	0
4.2	Huamarrja afatgjatë	0	0	0	0	0	0	0
5	**TRASHËGIMI NGA VITI I KALUAR**	116,363	133,339	608,251	608,251	250,000	250,000	0
5.1	Trashëgimi pa destinacion	116,363	133,339	608,251	608,251	250,000	250,000	0
5.2	Trashëgimi me destinacion	0	0	0	0	0	0	0
TOTALI I TË ARDHURAVE TË NJVQV		1,769,919	1,966,349	2,859,400	2,859,400	2,593,631	2,654,085	2,468,624

4.1.1.1 Të Ardhurat e Veta të Bashkisë Fier

Ky nënseksion paraqet informacion mbi të ardhurat e veta, përfshirë ato faktike për dy vitet e mëparshme, të pritshmet për vitin aktual dhe parashikimet për periudhën tre-vjeçare të PBA-së. Informacioni mbi supozimet që qëndrojnë në themel të këtyre parashikimeve paraqitet për secilin zë kryesor të të ardhurave të veta.

A. Taksat dhe Tarifat Vendore

A.1 Taksat Vendore

Taksat vendore përfshijnë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to; b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier; ç) taksa e tabelës; d) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj; dh) taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël; e) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore; ë) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.

A. 1 NUMRI I TAKSAPAGUESVE SIPAS GRUPIMEVE

Bashkia Fier ka gjithsej 67,542 familje taksapaguese, 5882 biznese dhe 35 institucione shteterore. Të dhënat janë marrë nga rregjistrat e gjendjes civile në qytet dhe në njesitë administrative dhe nga të dhënat e rregjistarave të Qëndrës Kombëtare të Biznesit. Më poshtë pasqyrohen numri i taksapaguesve sipas njësive administrative dhe rajoneve të Bashkisë Fier.

Nr	Njësia Administrative	Familjet	Bizneset	Institucione
1	Rajoni N.1	6,746	1,114	5
2	Rajoni N.2	9,089	1,015	4
3	Rajoni Nr.3	8,764	865	7
4	Rajoni Nr.4	8,032	1,438	15
5	NjA Cakran	4,497	110	1
6	NJA Dermenas	3,930	80	
7	NJA Frakull	2,934	110	
8	NJA Libofshe	3,041	170	1
9	NJA Levan	8,087	230	1
10	NJA Mbrostar	3,130	200	
11	NJA Portez	3,165	240	
12	NJA Qender	3,720	220	
13	NJA Topoje	2,407	90	
	Totali	**67,542**	**5,882**	**34**



Sic shihet nga tabela dhe grafiku i mësipërm peshën më të madhe me 93% e zënë taksapaguesit familjarë dhe me 7% e zë biznesi.

A.1.1 NUMRI I TAKSAPAGUESEVE FAMILJARE

Numri gjithsej i taksapagueseve familjarë është 67,542 familje, e cila si thame dhe më sipër ka peshën më të madhe të numrit të taksapagueseve të Bashkisë Fier.

Shperndarja e taksapagueseve familjarë në rajonet e qyetit dhe njësive administrative është përkatësisht 48.4% dhe 51.6%

Ne kater rajonet e qytetit numri eshte 32,631 familje taksapaguese, ndersa ne njesite administrative eshte 34,911 familje.

Ne evidentimin e kryer del se ka familje te cilat perfitojne lehtesira fiskale ne mbeshtetje te pika 6 e nenit 22 te Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar i cili cito nder te tjera se ……." *6. Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat: ë) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë; f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;*

Më poshtë paraqitet pasqyra e taksapagueseve familjarë sipas ngarkesës fiskale.

Nr	Njësia Administrative	Nr Familje	Familje me pagesë te plotë	Familje me lehtësi fiskale	Pensionistë, invalidë etj	Përfitues ndihmë ekonomike
1	Njësi admistrative	34911	32831	2080	1100	980
2	Rajone Qytet	32631	25841	6790	3800	2990
	Totali	**67542**	**58672**	**8870**	**4900**	**3970**

Referuar tabelës së mësipërme, familjet me lehtësi fiskale jane 2080 familje në njësitë administrative dhe 6790 familje në rajonet e qytetit. Familjet me lehtësi fiskale zënë 13 % të totalit të familjeve gjithsej taksapaguese.

A.1.2 TAKSAPAGUESIT TE BIZNESIT

